

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”  
FAKULTETI I FILOLOGJISË

MA EMIRA BAJÇINCA KONJUFCA

**KONCEPTI I IDENTITETIT SHQIPTAR NË REVISTËN**  
***HYLLI I DRITËS***

PUNIM I DOKTORATËS

Mentori:

Prof. Dr. Sali Bashota

**Prishtinë, 2024**

## Rezyme

Mediat vazhdimisht kanë qenë të ekspozuara ndaj ndryshimeve të mëdha. Qysh në fundshekullin XIX, e deri në ditët e sotme, zhvillimet në fushën e medias e të gazetarisë kanë qenë evidente. Element i pandryshueshëm në këtë rrafsh mbetet ndikimi i lartë që ushtron ky lloj mediumi në opinionin publik. Prandaj studimet të cilat trajtojnë çështjet e medias dhe të gazetarisë çdoherë janë të një rëndësie të pakontestueshme. Edhe ky disertacion në thelbin e vet e trajton median si të tillë meqë fushat të cilat elaborohen, analizohen e interpretohen i përkasin përmbajtjeve të një mediumi. Punimi me titull “Koncepti i identitetit shqiptar në revistën *Hylli i Dritës*” realizohet në kuadër të studimeve në programin “Shkencat e Komunikimit dhe Gazetarisë” në Departamentin e Gazetarisë – Fakulteti i Filologjisë, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”. Pjesa qendrore e punimit i trajton qëndrimet e revistës *Hylli i Dritës* në raport me identitetin kombëtar shqiptar.

*Hylli i Dritës* ishte një revistë e rëndësishme e kohës e cila filloi të botohej në vitin 1913. Ajo botohej në Shkodër dhe i përkiste Rendit Françeskan të Shqipërisë. Siç mund të kuptohet, pra, vitet përgjatë të cilave u botua revista përfshijnë periudhën në mes të dy luftërave botërore. Kjo ishte një periudhë shumë e rëndësishme kohore për mbarë globin, e po ashtu edhe për shqiptarët. Kjo revistë e kishte peshën e saj të padiskutueshme sidomos në mesin e elitave intelektuale të kohës. Ajo mblidhte rreth vetes figura të shumta intelektuale, klerikë e shkrimtarë të mirënjohur. Mund të thuhet pa dilemë se *Hylli i Dritës* ishte revista më e rëndësishme që botohej në Shqipëri në mes të dy luftërave botërore.

*Hylli i Dritës* filloi të botohej një vit pas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë, prandaj çështja e identitetit kombëtar zë vend të konsiderueshëm në të. Aty gjinden përgjigjet e ndryshme në çështjen e formësimit të identitetit kombëtar të shqiptarëve. Identiteti shqiptar trajtohet nga perspektiva e historisë, gjuhës, kulturës, prejardhjes, vetëdijes etj.

Punimi strukturohet në shtatë kapituj dhe secila pjesë e ka rëndësinë e saj. Këta kapituj përbëjnë shtatë dimensione esenciale të përmbajtjes së revistës. Qendra e punimit është koncepti i *Hyllit të Dritës* për identitetin kombëtar shqiptar. Por fushat e tjera të cilat trajtohen qëndrojnë në një lidhshmëri të vazhdueshme me këtë tematikë.

Pikënisja ka të bëjë me aspektin qytetërimor. Aty krishterizmi vendoset si shtrat kulturor i oksidentit. Revista duhet të kategorizohet përbrenda ligjëritit orientalist. Pikëvështrimi i revistës për civilizimin perëndimor, dijet humane dhe shkencën është kristianocentrik. Krishterizmi konsiderohet si identitet vleror i Perëndimit. Një përpjekje e vazhdueshme e revistës ka të bëjë me ofrimin e një sërë argumentesh për ta kundërshtuar tezën iluministe se krishterizmi dhe religjioni në përgjithësi është armik i shkencës, dijes dhe mendimit të lirë.

Në *Hyllin e Dritës* është konstant zhvillimi i qëndrimeve për religjionet monoteiste të botës. Katolicizmi vlerësohet si feja më e pranueshme dhe e drejtë. Jezu Krishti vendoset si zëvendës i Zotit kurse Papa si zëvendës i Krishtit. Selia e Shenjtë konsiderohet si vendi më i çmuar për katolicizmin. Në këtë kuadër sidomos çmohet rëndësia e Rendit Françeskan brenda Kishës Katolike.

Ortodoksizmi trajtohet vetëm në mënyrë të pjesshme por kryesisht në raport me identitetin kombëtar. Ekziston një perceptim negativ i revistës për ortodoksizmin që lidhet me përfundimin e tyre se kjo formë e religjionit e mban të zbehtë ndjesinë kombëtare të shqiptarëve në jug të Shqipërisë. Kjo pikëpamje ndikohet kryesisht nga polemikat e *Hyllit të Dritës* me revistën *Dielli* në të cilën mund të gjenden artikuj ku hedhen dyshime mbi karakterin kombëtar të veriut të Shqipërisë si dhe kundërshtime për shpalljen e Shkodrës si kryeqytet të shtetit shqiptar.

Islami lidhet me Perandorinë Osmane, kurse kjo e fundit konsiderohet si fatkeqësia më e madhe që historikisht i ka ndodhur kombit shqiptar. Shumica e veseve kolektive të popullit shqiptar shpjegohen përmes rrënjës së mendësisë otomane brenda shoqërisë shqiptare. Mirëpo *Hylli i Dritës* i jep hapësirë argumentit të përfaqësuesve të Neoshqiptarizmit se kjo nuk është një predispozitë osmane *par excellence*, por bizantine, dhe e cila është përvetësuar nga Perandoria Osmane, duke u përcjellur pastaj në masë të madhe te populli shqiptar.

Pjesa e dytë dhe qendrore e punimit e trajton kombin. Në shqyrtimin e kombit *Hylli i Dritës* duhet të vendoset në kornizën konceptuale të Rilindjes Kombëtare. Kombi kryesisht konceptohet nga një perspektivë organike dhe primordialiste. Aty mbrohet ideja e njëshmërisë së kombit shqiptar, autoktonësia dhe e drejta e tij për ta pasur shtetin e vet nacional.

Shqiptarët vendosen si pasardhës të drejtpërdrejtë të ilirëve. Kurse këta të fundit konsiderohen si pasardhës të pellazgëve – një popullatë parailire e parahelene, populli më i lashtë evropian. Gjithashtu revista mban një qëndrim të drejtpeshuar kur bëhet fjalë për marrëdhënien mes fesë dhe kombit.

Në trajtimin e identitetit kombëtar nga *Hyllit i Dritës* është interpretuar një vijë e qartë ndarëse e cila si pikë reference e ka shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë. Përderisa në horizontin konceptual kombi shqiptar e transcendon gjeografinë politike, në rrafshin praktik të shqyrtimit të elementeve të cilat e konsolidojnë, apo e pengojnë, korpusin kombëtar, Shqipëria londineze mbetet korniza identitare e *Hyllit të Dritës*. Rajonet tjera ku jetonin pjesa më e madhe e shqiptarëve – Kosova dhe viset e Jugosllavisë Mbrëtërore, mënjanohej nga trajtimi.

Në *Hyllin e Dritës* kombi trajtohet po ashtu duke e pasë në konsideratë kontributin e veçantë të popullsisë katolike. Nënvizohet vazhdimisht veprimtaria e klerit dhe e popullatës katolike në çdo fazë të rëndësishme të luftës kombëtare për liri, prej kohës së Gjergj Kastriotit, duke e veçuar kryengritjen antiosmane të Pjetër Bogdanit, Kuvendin e Arbërit, pastaj kryengritjen e Dedë Gjo Lulit, shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë etj.

Në pjesën e tretë shtrohet çështja e gjuhës shqipe. Në revistë përgjithësisht mbrohet ideja se shqipja është komponenta bazike e identitetit kombëtar shqiptar. *Hylli i Dritës* avokonte fuqishëm për njësimin e gjuhës shqipe në një gjuhë të standardizuar moderne. Nga dimensionin e raportit të shqipes me gjuhët e tjera Ballkanike, *Hylli i Dritës* argumenton nga një perspektivë albanocentrike.

Sërish e gjejmë edhe këtu lidhjen e historisë së gjuhës shqipe me kontributin e popullatës katolike. Aq vendimtar e koncepton *Hylli i Dritës* këtë kontribut sa që konkludon se po të mos llogaritet kjo pjesë, nuk do të kishim fare histori të gjuhës shqipe. Autorë si Gjon Buzuku e Frang Bardhi, Pjetër Budi e P. Bogdani, Jul Variboba e Dhimitër Kamarda, Jeronim De Rada e Gjergj Fishta – nuk ishin thjesht vetëm shkrimtarë pa të cilët nuk mund të mendohet letërsia shqipe, por edhe të mbrujtur në krishterizëm.

Pjesa e katërt i kushtohet punimeve të shumta të revistës për figurën e Gjergj Kastriotit. Skënderbeu vendoset si figura qendrore e historisë dhe vetëdijes kombëtare shqiptare. Kontributi i tij në pikëvështrimin e *Hyllit të Dritës* është i pakrahasueshëm. Veçantia e *Hyllit* është se Gj. Kastrioti vendoset në kontrast të plotë me Lekë Dukagjinin. Rënia e hapësirave shqipëtare në okupimin otoman shpjegohet kryesisht me arsyen e vdekjes së Skënderbeut. Boshllëku që e la vdekja e tij nuk mund të kompensohej.

Pjesa e pestë i kushtohet perceptimit të revistës ndaj figurave kryesore politike e publike të cilat vepronin në kohën kur botohej ajo. Luftërat Ballkanike, shpallja e pavarësisë së Shqipërisë, Konferenca e Ambasadorëve në Londër, protektorati i Fuqive të Mëdha mbi Shqipërinë nën

udhëheqjen e Princit gjerman të Wiedit dhe zhvillimet tjera deri te Revolucioni i Qershorit – të gjitha këto shqyrtohen duke e analizuar qëndrimin e revistës për protagonistët kryesorë të kohës: Ismail Qemalin, Fan Stilian Nolin, Ahmet Zogun, Esad Pashë Toptanin, Luigj Gurakuqin, Bajram Currin e Avni Rrustemin. Çuditërisht asnjë fjalë për Hasan Prishtinën.

Këto pozicionime të revistës kanë një rëndësi origjinale meqë po bëhet fjalë për ngjarje, zhvillime e personalitete të kohës kur botohej *Hylli i Dritës*. Nga këto qëndrime mund ta shqyrtojmë më së miri principin universal të mitizimit të figurave kombëtare përmes distancimit të nevojshëm kohor. Kjo vlen sidomos për I. Qemalin.

Në kapitullin e gjashtë shpjegohet qëndrimi i *Hyllit të Dritës* ndaj ideologjive globale të kohës. Ana e errët e revistës mbetet qëndrimi pozitiv i saj ndaj fashizmit të Benito Mussolinit. Krimet e fashizmit minimizohen. Kurse aneksimi i Shqipërisë nga Italia mirëpritet si ngjarje e rëndësishme për ecjen përpara të shtetit.

Kurse në pjesën e fundit të punimit trajtohet *Hylli i Dritës* si shembull tipik i medias klasike. Ajo u ribotua edhe pas rënies së diktaturës komuniste. Përpjekja ishte për ta ruajtur identitetin dhe strukturën klasike. Revista vendoset në analizë krahasimtare me median e re duke i vënë në pah vështirësitë e mediave klasike të cilat refuzojnë të ndryshojnë në hap me invencionin teknologjik.

Në kuadër të këtij punimi është realizuar një hulumtim i opinionit përmes anketave si pjesë e metodologjisë shkencore. Në intervistim janë përfshirë 1051 respondentë. Kosova është një ndër vendet e pakta të botës ku tashmë nuk ka asnjë të përditshme të shtypur. Hulumtimi vie në përfundimin që revistat në Kosovë kanë presion të madh për të kaluar në media online. Shumë prej tyre e kanë bërë këtë transformim. Ky është një trend i mirënjohur global.

Material bazik i punimit janë 98 numra të *Hyllit të Dritës*. Për t'i formuluar tezat e konkludimet si dhe për t'i bërë shpjegimet e vendosura brenda një konteksti të duhur e të nevojshëm teorik është shfrytëzuar një literaturë e gjithanshme shkencore nga lëmi i gazetarisë, gjuhësisë, historisë, sociologjisë etj.

Studimet dhe botimet në fushën e analizës shkencore të revistave të hershme në gjuhën shqipe janë të pakta. Posaqërisht për *Hyllin e Dritës*. Ende nuk e kemi një botim gjithëpërfshirës shkencor për përmbajtjen e kesaj reviste. Ky ishte një motiv shtesë për zgjedhjen e kësaj teme të doktoraturës.

## Resume

The media has constantly been exposed to major change. Development in the field of media and journalism has been evident from the end of the 19<sup>th</sup> century, and onwards. A constant element in this regard has been the significant influence of the media on public opinion. This makes studies of media and journalism always of indisputable value. At its core, this dissertation addresses the media as it elaborates, analyzes, and interprets the contents of a specific media, the magazine, *Hylli i Dritës*.

This study, entitled, “The concept of Albanian identity in the magazine *Hylli i Dritës*” is carried out as part of the Sciences of Communication and Journalism program at the Department of Journalism, in the Faculty of Philology, at the University of Pristina, “Hasan Prishtina”. The central part of the paper deals with the positions taken by *Hylli i Dritës* magazine, in relation to the Albanian national identity.

*Hylli i Dritës* was an important magazine of the period when it was first published in 1913. It was published in Shkoder and belonged to the Franciscan Order of Albania. The years when the magazine was published include the period between the two world wars. This was a very significant period for the world, and for Albanians.

This magazine was of unquestioned importance, especially among the intellectual elites of the time. It was associated with numerous intellectual figures, well-known clergymen, and authors. It can be stated, without a doubt, that *Hylli i Dritës* was the most important magazine published in Albania between the two world wars.

*Hylli i Dritës* was first published one year after the declaration of Albania's independence, therefore considerable space was devoted to national identity. Different answers to the question of the formation of the national identity of Albanians can be found in the magazine. Albanian identity is addressed from the perspective of history, language, culture, origin, and consciousness, etc.

The study is organized in seven chapters each of which is important. These chapters address seven essential dimensions of the magazine's content. The core of the paper is the concept of

Albanian national identity explored in *Hylli i Dritës*. Other issues addressed are related to this theme.

The starting point of the study is the civilizational context. In this respect, Christianity is established as the cultural foundation of the Occident. The magazine should be categorized as part of the orientalist discourse. The magazine's view of Western civilization, the humanities, and science is Christocentric. Christianity is considered a valued identity of the West. The magazine is engaged in an ongoing effort to provide a series of arguments to counter the Enlightenment thesis that Christianity and religion in general is the enemy of science, knowledge, and free thought.

In *Hylli e Dritës* there is a constant development of attitudes about the world's monotheistic religions. Catholicism is regarded as the most acceptable and just religion. Jesus Christ is established as God's deputy and the Pope as Christ's deputy. The Holy See is considered the most sacred place for Catholicism. The influence of the Franciscan Order within the Catholic Church is especially appreciated.

The Orthodox faith is addressed only partially, and mainly in relation to national identity. The magazine has a negative perception of the Orthodox church, as they conclude that it represses the national feeling of the Albanians in the south of Albania. This viewpoint is mainly influenced by the polemics between *Hylli i Dritës* magazine and *Dielli* magazine, when the latter casts doubt on the national character of the north of Albania and objects to the declaration of Shkodra as the capital of the Albanian state.

Islam is associated with the Ottoman Empire, and the magazine considers it the greatest historical disaster to have happened to the Albanian nation. Most of the collective vices of the Albanian people are explained as the outcome of the adoption of the Ottoman mentality by Albanian society. However, *Hylli i Dritës* also gives space to the argument of the representatives of Neo-Albanianism that this mentality is not an Ottoman predisposition *par excellence*, but a Byzantine approach, which was adopted by the Ottoman Empire, and then communicated to a large proportion of the Albanian people.

The second and central chapter of the study deals with the nation. In its consideration of the nation *Hylli i Dritës* must be placed in the conceptual framework of the National Renaissance. The nation is primarily conceived from an organic and primordial perspective. It defends the idea

of the unity of the Albanian nation, its autochthonous character, and the right to have its own national state.

Albanians are established as the direct descendants of the Illyrians. And the latter are considered descendants of the Pelasgians- a pre- Illyrian and pre- Hellenic population, the most ancient European people. The magazine takes a balanced view of the relationship between religion and the nation.

In the treatment of national identity by *Hylli i Dritës*, a clear dividing line is drawn, which takes as a reference point the declaration of independence of Albania. While on the conceptual horizon, the Albanian nation transcends political geography, on the practical level of examining the elements that consolidate, or hinder, the national corpus, London Albania remains the framing identity of *Hylli i Dritës*. The other regions where the majority of Albanians lived - Kosovo and parts of the Kingdom of Yugoslavia - are excluded from analysis.

In *Hylli e Dritës* the nation is also addressed by taking into consideration the particular contribution made by the Catholic population. The activity of the clergy and the Catholic community, in every important phase of the national struggle for freedom, from the time of George Castriota, is constantly underlined, and they highlight the anti-Ottoman uprising of Peter Bogdani, the Assembly of Arber, the uprising of Dedë Gjo Luli, and the declaration of independence of Albania etc.

The third chapter examines the treatment of the Albanian language. The magazine generally defends the idea that the Albanian language is the basic component of the Albanian national identity. *Hylli i Dritës* strongly advocates for the unification of the Albanian language in a standardized, modern language. It also takes an Albanian-centric perspective of the relationship of the Albanian language to other Balkan languages.

Again, we find here a connection made between the history of the Albanian language and the contribution of the Catholic population. *Hylli i Dritës* considers this literary contribution so decisive that it concludes that if ignored, there would be no history of the Albanian language at all. Authors like Gjon Buzuku and Frang Bardhi, Peter Budi and Peter Bogdani, Jul Variboba and Dhimiter Kamarda, Jeronim De Rada and Gjergj Fishta - are not just viewed as authors, without whom Albanian literature would not exist, but also as defenders of Christianity.

The fourth chapter of the study is devoted to the numerous articles in the magazine about the character of George Castriota Skanderbeg. Skanderbeg is established as the central figure of



Albanian history and national consciousness. According to the view of *Hylli i Dritës*, his contribution is incomparable. The unique approach of *Hylli i Dritës* is to contrast Skanderbeg with Leke Dukagjini. The decline of the Albanian territories in the Ottoman occupation is explained largely as the result of the death of Skanderbeg. The void left by his death could not be filled.

The fifth chapter is dedicated to the magazine's perception of the key political and public figures who were active at the time it was published. The Balkan Wars, the declaration of the independence of Albania, the Conference of Ambassadors in London, the protectorate of the Great Powers over Albania under the leadership of the German Prince of Wied, and other developments up to the June Revolution - all of these developments are examined by analyzing the attitude of the magazine toward the leading protagonists of the time: Ismail Qemali, Fan Stilo Noli, Ahmet Zogu, Esad Pasha Toptani, Luigj Gurakuqi, Bajram Curri and Avni Rrustemi. Surprisingly there is not a word about Hasan Pristina.

The positions taken by the magazine have a unique value since we are talking about the events, developments, and personalities of the time when *Hylli i Dritës* was being published. Using this analysis, we can better examine the universal principle of the mythologizing of national figures with the necessary time and distance. This applies especially to Ismail Qemali.

The sixth chapter addresses the attitude of *Hylli i Dritës* towards the world ideologies of the time. The dark side of the magazine is its positive attitude towards Benito Mussolini's fascism. The crimes of fascism are minimized. The annexation of Albania by Italy is welcomed as an important event for the state's progress.

In the last chapter, *Hylli i Dritës* is treated as a typical example of classical media. It was reprinted after the fall of the communist dictatorship. An effort was made to preserve its identity and classical structure. A comparative analysis is conducted of the magazine and new media, highlighting the difficulties of classic media, which refuse to change in step with technological innovation.

In the course of this study, opinion research was conducted through surveys using a scientific methodology. Interviews were conducted with 1,051 respondents. Kosovo is one of the few countries in the world where there is no daily printed newspaper. The research concludes that magazines in Kosovo are under great pressure to switch to online media. Many of them have made this transformation. This is a well-known global trend.

The 98 issues of *Hylli i Dritës* constitute the basic research material of the study. In order to formulate the theses and conclusions in the study, and to situate the explanation within the appropriate and necessary theoretical context, a comprehensive review of scientific literature from journalism, linguistics, history, sociology, etc. was also conducted.

There are few studies and publications involving the scientific analysis of early magazines in the Albanian language, and specifically for the magazine, *Hylli i Dritës*. We still lack a comprehensive scientific publication about the contents of this magazine. This was an additional motivation for choosing this PhD topic.